KËRKESË
Nr.4518/2, datë 7.10.2009

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i impiantit të trajtimit të ujërave të përdorura, Korçë.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Shoqëria Aksionare Ujësjellës-Kanalizime Korçë. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për pronarët, sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 4 345 000 (katër milionë e treqind e dyzet e pesë mijë) lekë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA JURIDIKE
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I KOLEKTORIT TË GRUMBULLIMIT TË UJËRAVE TË PËRDORURA PËRGJATË SUPËRSTRADËS KORÇË-KAPSHTICË

Nr.	**Emri, mbiemri i pronarit**	**Nr. i pasurisë**	**Z.Kadastrale**	**Lloji i pasurisë**	**Sipërfaqja m^2**	**Çmimi lekë/m^2**	**Vlera totale lekë**	**Shënime**
1	Vasil Panariti	8/251	8561	truall	166.2	10 000	1 662 000	Konfirmim ZRPP
2	Nikolla Ligor Çeço	8/50	8561	truall	268.3	10 000	2 683 000	Konfirmim ZRPP
	Totali lekë						**4543000**	